

12

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire
des Nations Unies au
Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 16 JANAR 2003

TRANSKRIPT

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA,
ODRŽANE 16. 01. 2003. GODINE

JANAR – JANUAR
2003

//



PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për Mbrojtjen e Ambientit
4. Shqyrtimi i propozimit të Kryesisë për emërimin e një anëtari në Komisionin për Peticione dhe Kërkesa Publike
5. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pyetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashtrës të paktën pesë ditë pune por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВН РЕД

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
3. Друго разматрање Нацрта Закона о Заштити Средине
4. Разматрање захтева Председништва за именовање једног члана Комисије за Јавне Молбе и Жалбе
5. Постављање питања

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 16 JANAR 2003

Seanca filloi punën në orën 10.

Seancën e kryesoi Akademik NEXHAT DACI, kryetar i Kuvendit të Kosovës.

Bashkëkryesues HYDAJET HYSENI, anëtar i Kryesisë së Kuvendit.

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes të nderuar kolegë deputetë.

Shpresoj se me kohë keni marrë propozimin e rendit të ditës për këtë seancë. Jam i bindur se këtë rend të ditës do ta miratojmë, edhe pse në dukje kemi pak punë pasi që kemi vetëm një ligj, por ka aq shumë amendamente, që kundërshtojnë njëri-tjetrin, sa që prapëseprapë do të kemi punë mjaft. Megjithkëtë, është e drejtë e seancës plenare ta aprovojë apo jo këtë.

Prandaj, pyes deputetët – a mund të fillojmë punën me këtë rend të ditës? Ju falemnderit.

Kalojmë në pikën vijuese të rendit të ditës – **Miratimi i Procesverbalit nga seanca e kaluar.**

Shpresoj se deputetët, nëse kanë vërejtje apo sygjerime në Procesverbalin e seancës së kaluar dhe nuk shprehë frymën e debatit të zhvilluar, do ta përdorin praktikën dhe ato t'i bëjnë me shkrim e të bëhen përmirësime, sepse kjo është mënyra më e mirë e punës.